

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Studim projektimi parku urban spitallë”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** [71335000-5 – Studime inxhinierike](#)

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,492,686** (dy milion e katërqind e nentëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

Afati i shërbimeve do të jetë për një periudhë 70 ditë.

Në zbatim të urdhrin të grupit të specifikimeve Nr.558 Datë 07.11.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike i pasi u njoh me objektin e prokurimit, programoi punën për përlllogaritjen e vlerës së projektit dhe hartimit të specifikimeve teknike duke u mbështetur në keto dokumenta:

- Vendimi vkm nr.354, datë. 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.
- Urdhërit Nr.5 të Agjencisë datë 12.01.2021 “Për miratimin e rregullores për formatin e auditimit energjitik dhe pagesa për audituesin energjitik.
- Investime të kryera nga Bashkia në objekte të ngjashme.
- Buxhetin e Bashkisë Durrës.
- Vendim nr. 319, datë 12.4.2017 për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave dhe standardet e projektimit të shkollave.

**PERLLOGARITJA E VLERES LIMIT TE KONTRATES**

**Per perlllogaritjen e vleres limit te kontrates, Mbeshtetur ne Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:**

Ne perlllogaritjen e vleres limit te kontrates, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet nje ose me shume alternativave te renditura si me poshte: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave

(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet perkatese (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtise, ne manuale etj): ose/dhe:

- a) Çmimet e tregut; ose/dhe .
- b) Çmimet e kontratave të meparshme, të realizuara nga vete apo nga autoritete të tjera kontraktore:ose/dhe çmimet nderkombetare, të botuara.

Për llogaritjen e vlerës së projektit grupi i punës, sic edhe është theksuar më lart është mbështetur në Vendimin vkm 354 dt. 15.01.2016, dhe në punime të ngjashme.

Llogaritja e vleres se projektit u bë duke u mbështetur në investimet e bëra në:

1. rikonstruksionin e segmentit rrugës Aleksandër Goga. , nga Teatri Aleksandër Mojsiu deri në kryqëzimin të Mauzoleumi i Dëshmorëve,
2. rikonstruksion i rrugës “Egnatia” si dhe
3. rehabilitimi i dy shesheve në lagjen nr.6 dhe nr.13, përkatësisht si më poshtë:

#### 1. Rikualifikim hapësira publike në lagjen nr.6 me sipërfaqe 370 m<sup>2</sup>

Me vlerë preventivi: 3.470.639 lekë pa tvsh Kostoja e investimit është 9385 lek/m<sup>2</sup>.

#### 2. Rikualifikim hapësira publike në lagjen nr.13 me nje sipërfaqe prej 2074 m<sup>2</sup>., me vlerë preventivi: 15 351 953 lekë pa tvsh Kostoja e investimit është 7402 lek/m<sup>2</sup> .

3. Rikonstruksioni segmentit të parë të rrugës “Aleksandër Goga” zhvillohet në një sipërfaqe rreth 11,000 m<sup>2</sup>, nga Teatri Aleksandër Mojsiu deri në kryqëzimin të Mauzoleumi i Dëshmorëve.

Vlera e preventivuar e rikonstruksionit të kësaj rruge të bërë nga Bashkia është rreth 83.000.000 lekë pa tvsh. Kostoja e investimit është 7,545 lek/m<sup>2</sup> .

4. Rikonstruksioni i aksit rrugor Deshmoret dhe Egnatia Loti II” zhvillohet në një sipërfaqe rreth 18 864 m<sup>2</sup>

Vlera e preventivuar e rikonstruksionit të kësaj rruge të bërë nga Bashkia është rreth 211,488,977 lekë pa tvsh. Kostoja e investimit është 11 211 lek/m<sup>2</sup>.

Duke marrë në analizë këto objekte kostoja për m<sup>2</sup> e investimeve të kryera është 8110,66666 lekë pa tvsh.

Kosta e përafërt e llogaritur për realizimin e këtij projekti “Parku Urban Spitallë”, nisur nga investimet e bëra nga Bashkia është gjerësi (varion 9m-10 m) \* gjatësi 1.08 km =10 000 m<sup>2</sup> x 8110.666666 lekë/ m<sup>2</sup> është 81 106 666,67 lekë pa tvsh.

Mbështetur në V.K.M. 354, datë. 15.01.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Seksioni IV, Strukturat e transportit dhe qarkullimit, neni 40, 42, 44, tabela 12, tabela shoqëruese e tarifave – strukturat e transportit (qarkullimi), tabela 3: Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit, për strukturat e transportit po llogarisim më poshtë vlerën e projektit.

Vlera 81 106 666,67 lekë nuk gjendet në tabelën nr. 12, tabela shoqëruese e tarifave – strukturat e transportit, kështu do të bëjmë interpolimin midis dy vlerave që gjejmë në këtë tabelë, në grupin tarifor nr III dhe pikërisht vlerës 70 000 000 dhe 105 000 000.

Sipas grupit tarifor III përqindjet e projektimit për vlerën 70 000 000 lekë është 4,25% dhe 4.85% dhe për vlerën 105 000 000 lekë është 3,71 % dhe 4,21 %.

Duke bërë interpolimin midis këtyre vlerave na dalin koficientët, minimalë 4,02816% dhe maksimal 4,58708 %.

Duke u mbështetur në këto përqindje:

- Vlera minimale e projektit për nëntë fazat sipas tabelës nr. 3 Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit është :  
 $4,02816\% * 81\ 106\ 666,67 = 3\ 267\ 106,3$  lekë pa tvsh.
- Vlera maksimale e projektit për nëntë fazat sipas tabelës nr. 3 Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit  
 $4,58708\% * 81\ 106\ 666,67 = 3\ 720\ 427,6$  lekë pa tvsh.

Bazuar në tabelën nr. 3, Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit, nga studio projektuese do të kërkojmë të realizohen këto faza projektimi:

- Analize detyres projektimit 2 %
- Projekt ideja paraprake 10%
- Projekt ideja përfundimtare 20 %
- Projekt për miratimin e lejes ndertimit 5%
- Projekt zbatimi 20%
- Preventivi përfundimtar 10%

Shuma e këtyre fazave është 67%.

- Vlera minimale e projektit për gjashtë faza: faza e parë deri faza e gjashtë është 67% e vlerës minimale  $3\ 267\ 106,3$  lekë \* 67 % =  $2\ 188\ 961,2$  lekë pa tvsh
- Vlera maksimale e projektit për gjashtë faza: faza e parë deri faza e gjashtë është 67% e vlerës maksimale:  
 $3\ 720\ 427,6$  lekë \* 67 % =  $2\ 492\ 686,4$  lekë pa tvsh

Mbështetur në llogaritë e më sipërme sipas VKM. 354, vlera fondit limit për projektin

**“STUDIM PROJEKTIMI PARKU URBAN SPITALLË”** duke marrë në analizë investimet e fundit që ka kryer Bashkia në rrugë është **2 492 686** lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e references) dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5 ;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 900’000 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet

dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

*Kërkesa e mesipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe mbështetet në nënin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nënin 77, pika 3, e LPP, si dhe nënin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 të DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nënin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore.*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 900'000 lekë,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në fushën e projektimit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

Kategoria 2.d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Kategoria 4.i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

Kategoria 5.c- Ujësjellës-kanalizime urbane - rurale.

- Kategoria 6.a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- Kategoria 8.a- Rilevime Inxhinierike.
- Kategoria 11.a- Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimnr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim"

Argumentimi:

- Kategoria 2.d kërkohet për arsyen se arkitekti do të vleresojë dhe projektojë projektin e parkut me elementet arkitekturore, arredimin urban etj.
- Kategoria 4.i kërkohet për arsyen se projektuesi instalator do të realizojë projektet e ndriçimit rrugor, shesheve nëse ka etj.
- Kategoria 5.c kërkohet për arsyen se projektuesi do të realizojë projektin e (KUB E KUZ)
- Kategoria 6.a kërkohet për arsyen se projektuesi i rrugëve do të realizojë projektin e rrugës lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.
- Kategoria 8.a kërkohet për arsyen se projektuesi gjeodet do të realizojë rilevimin topografik të gjithë zonës ku do të zhvillohet projekti.
- Kategoria 11.a kërkohet për arsyen se projektuesi i sinjalizimit rrugor, do të realizojë projektin e sinjalistikës në Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**,si më poshtë:

- |  |   |
|--|---|
| • PROJEKTUES ARKITEKT                          | 1 |
| • PROJEKTUES INSTALATOR.                       | 1 |
| • PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE.                 | 1 |
| • PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA.                | 1 |
| • PROJEKTUES GJEODET.                          | 1 |
| • PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.           | 1 |
| • EKSPERT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS. | 1 |

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të natyrës së objektit dhe projektit që do të realizohet Konkretisht:**

- PROJEKTUES ARKITEKT kërkohet për arsyen se arkitekti do të hartojë projektin e parkut me elementet arkitekturore, arredimin urban etj.
- PROJEKTUES INSTALATOR kërkohet për arsyen se do të realizojë projektet e ndriçimit rrugor, shesheve, nëse ka etj
- PROJEKTUES VEPRË HIDRAULIKE kërkohet për arsyen se do të realizojë projektet e kanalizime (KUB dhe KUZ)
- PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA. kërkohet për arsyen se do të realizojë projektin e rrugës objekt prokurimi në bazë të kushteve teknike të projektimit me të gjitha elementet përbërës të një projekti.
- PROJEKTUES GJEODET kërkohet për arsyen se do të realizojë rilevimin topografik të rrugës ekzistuese
- PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR. kërkohet për arsyen se, do të realizojë projektin e sinjalistikës në rrugore.
- EKSPERT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS, kërkohet për arsyen se ai do të hartojë raportin e ndikimit në mjedis

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 7 persona** (Numri prej 7 personash përfshin personelin kryesor si dhe stafin mbështetës) në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

*Këto kritere përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12 të DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që



ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme

- paisjet gjeodezike, total station, gps.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*paisjet gjeodezike, total station, gps, janë të nevojshme sepse me anë të tyre do të bëhet rilevimi topografik i zones ku do të shtrihet investimi.*

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

### 2.4.1.....

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Detyra e projektimit & Termat e references dhe procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim, të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e

specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave te references/detyres se projektimit, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e meposhteme:

**1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:**

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Shërbim konsulence”**

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-85484-10-26-2023**

**4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Studim projektmi parku urban spitallë”.**

**5. Fondi limit: 2,492,686** (dy milion e katërqind e nentëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 70 ditë.**

**7. Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje:**

Data: **07.11.2023** Ora: **10:00**

Vendi: mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Vendi: mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit te gjithë anetaret e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

**Njësia e Prokurimit**